



**RELACION TEKNIK
PROJEKT RESTAURIMI
URA E MESIT, GJIROKASTER**

PËRMBLEDHJE:

| | |
|---|---|
| VENDNDODHJA..... | 3 |
| ANALIZA HISTORIKE DHE ARKITEKTONIKE | 3 |
| GJENDJA EKZISTUESE | 6 |

VENDNDODHJA

Ura e Mesit është një nga tre urat e ngritura përgjatë përroit të Zerzebilit, në krahun jugor të kalasë së Gjirokastrës, dhe përkatësisht më koordinata gjeografike, $40^{\circ} 4'18.31''N$ dhe $20^{\circ} 8'21.95''E$. Ura e mesit ka status pasuri kulturore kategoria e I, shpallur me urdhëresë të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, datë 08.01.1977.



Fig. 1 Vendndodhja e urë në lidhje me kalanë e Gjirokastrës

ANALIZA HISTORIKE DHE ARKITEKTONIKE

Sa i përket datimit të urës nuk kemi informacion. Duke u bazuar nga ana konstruktive, mendohet se kjo urë daton në Shk. XIX.

Ura e Mesit është një urë e vogël, e tipit me një qemer në formë gjysmë rrethi me diametër rreth 1.8m. gjatësi 3.5 m dhe gjerësi 2 m. Muret bregore të urës si dhe barku/harku i urës është ndërtuar me gurë gëlqeror me trashësi deri në 15cm. Qemeri i urës ndërtuar me gurë gëlqeror të punuar, ka një kornizë të quajtur “Harku Vetull” më i dalë disa cm përgjatë gjithë gjatësisë së tij, i punuar me gurë gëlqeror me dimensione jo më të mëdha së 5 cm. Ura ka shërbyer për të lidhur dy lagjet e qytetit atë të Manalatit me lagjen Dunavat.

Ura me qemer gjysmë rrethi janë urat më të përhapura dhe hasen jo vetëm gjatë rrugëve të rëndësishme të krahinës por edhe në fshatra dhe zona të izoluarra nëpër rrugë sekondare apo rrugë të brendshme në vendbanimet e asaj kohe. Gurët janë me dimensione relativisht të vogla dhe janë të vendosura në formë radhorë.



Fig. 2- Pamje e bjefit të poshtëm



Fig. 3- Pamje e bjeftit të poshtëm



Fig. 4- Pamje e bjeftit të sipërm



Fig. 5- kalldrëmi i urës, hyrja nga ana e kalasë

GJENDJA EKZISTUESE

Siç mund të shihet edhe nga forograftit e paraqitura më sipër, ura është në gjendje jo të mire konstruktive.

- Në bjeftin e sipërm, nga krahun e djathtë shpatulla e urës pothuaj është inekzistentë. Është prishur plotësisht duke nxjerr në dukje gjithë gurët e qemerit. Si e tillë forcat shtytëse horizontale të qemerit kanë bërë që gurët në këtë pjesë të lëvizin për nga jashtë duke krijuar deformim të harkut të qemerit. Një faktor tjetër i cili ka ndikuar në destabilitetin e urës është edhe vendosja e një tubacioni të ujësjellësit i cili kalon për së gjati në qemer (i dukshëm edhe nga foto e urës).
- Siç mund edhe të shihet në Fig. 5, kalldrëmi i urës është shumë i dëmtuar, dhe pjesërisht i mbuluar nga dherat e hedhur ndërvite.
- Në gjithë trupin e urës ka prezencë të patinës biologjike si dhe të bimësisë.
- Si pasojë e mos përdorimit për një periudhe të gjatë kohore, dhe ndikimit të faktorëve natyror kemi një degradim të lidhësit në muraturë.
- Si pasojë e degradimit të lidhësit, dhe infiltrimit të lagështisë në muraturën e urës ka krijim të njollave dhe ç'ngjyrosje të gurit gëlqeror.

- Mungesa e lidhësit ka bërë që gurët e dy kornizave të kalldrëmit të urës të të bien, duke arritur edhe në rënien e gurëve nga “Harku Vetull” i qemerit.
- Mungesa e lidhësit ka shkaktuar gjithashtu edhe shkëputje të gurëve dhe krijimin e zgavrave në muraturen e urës.
- Nga të dyja anët e urës, shpatullat e saj janë mbuluar nga dherat të hedhur të cilët mbuluar plotësisht këmbët e urës.

GJENDJA AKTUALE




Fig. 6- Deformimi i qemerit, bjeri i sipërm dhe tubacioni i vjetër i ujësjellësit

NDËRHJRJET E PROPOZUARA

Duke marrë në konsideratë gjendjen kritike ekzistuese të urës propozohen ndërhyrjet restauruese si më poshtë:

- Pastrimin e muraturës nga vegetacioni dhe patinës biologjike me anë të disinfektimit me produkte biocide;
- Heqja e tubacionit të vjetër të ujësjellësit;
- Pajantimi i qemerit me strukturë druri, sipas grafikës së projektit;
- Pastrimi nga mbetjet (Llaç i degraduar) dhe papastërtit në muraturë;
- Çmontimi i pjesshëm i qemerit;
- Rimontimi i qemerit me gurët ekzistues duke.
- Plotësimi i "Harkut Vetull" me gurë të ngjashëm me ato ekzistues;
- Plotësim me muraturë guri i shpatullave të urës;
- Rifugatimi i muraturës me llaç gëlqere të staxhionuar;
- Konsolidim me injektim i gjithë muraturës së gurit të urës;
- Restaurim dhe plotësim i kalldrëmit;
- Heqje e pajantimit;
- Çlirimi i shpatullave të urës nga mbushja e dherave të hedhur;
- F.V tabelë informative.